

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“GENKON AL” sh.p.k

Themeluesit qe nenshkruajne me poshte jane si vijon:

Z. MURAT SALCI, i datelindjes 21.11.1976, atesia Salih, amesia Seher, lindur ne Uskudar/Turqi dhe banues ne Yedinci sunetci sok. N.16/B Milas Mugla /Turqi, identifikuar me pasaport nr. U15322148 dhe nr personal turk 52153236096 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Znj. OLGA CEYLAN, i datelindjes 12.03.1975, atesia Igor, amesia Marina, lindur ne Moske/Rusi dhe banues ne Torba Cad. Bilur Sitesi, 1201A Bodrum Mugla/Turqi, identifikuar me pasaport nr. U26812853 dhe nr personal turk 51586167762 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhen Ortaket e Shoqerise “GENKON AL” sh.p.k

Sot me date **25.04.2024**, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosen te themellojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK
Neni 1
Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “GENKON AL” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Sherbime konsulence inxhinierike. Hartim projektesh, ndjekje punimesh, supervizime per te gjitha llojet e ndertimeve konsulence teknike ne fushen e telekomunikacionit, elektrikes, elektronikës, teknologjise, ndertimit dhe materialeve ndihmese. Ndertimi dhe zbatimi i te gjithe projekteve te ndertimit. Apartamente banimi, vila, fshat turistik, ndertesa industriale, kapanone dhe cdo strukture detare. Shkembimin, shitjen, dhenien me qira, manaxhimin, administrimin e pasurive te luajteshme dhe paluajteshme, ne pronesi te vet, te te treteve ose te dhena me qira financiare, si ndertesa civile, tregtare apo industriale. Prodhim dhe shit-blerje te materialeve te ndertimit. Perdorimi, importi dhe eksporti i materialeve te ndryshme per perdorim ne ndertesa civile dhe industriale.

Neni 2
Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne “GENKON AL” sh.p.k

1. Selia juridike e Shoqerise ndodhet Lagja Pavarsia, Rr.Gjergj Araniti, Nd. Nr.18, H.1, Kodi Postar 9401, Vlore Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3
Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ortakeve mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar.

- Ne kete rast ortaket do ta pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
 4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaku ka te drejte te marri te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III **KAPITALI THEMELTAR**

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **500.000 (peseqind mije) Leke. 2 (dy) kuota gjithsej.**

Ortaku i shoqerise eshte:

1. **Murat Salci**, zotërues 1 (nje) kuote me vlere 250.000 lek, qe perfaqeson **50% (pese dhjete perqind)** kapitalin themeltar të shoqërisë;
2. **Olga Ceylan**, zotërues 1 (nje) kuote me vlere 250.000 lek, qe perfaqeson **50% (pese dhjete perqind)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

Kreu IV **PERSONALITETI JURIDIK**

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V **ADMINISTRIMI**

Neni 8

Shoqeria do te administrohet nga administratoret **Murat Salci dhe Olga Ceylan**, te cilet perfaqesojne shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare ne menyre te varur nga njeri-tjetri dhe me te drejte rizgjedhje.

Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA
Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise.

Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.

Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ortakët Themelues

MURAT SALCI

Murat Salci
MS

OLGA CEYLAN

Olga Ceylan
OC